



**Buxheti i Bashkimit European: Ku shkojnë paratë?
SHBA dhe BE, drejt marrëveshjes së tregtisë së lirë
Transparenca si konspiracion**

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr. 15 Shkurt - Mars 2013

Speciale

Rinia Shqiptare përballë institucioneve dhe zgjedhjeve: Konfuze dhe e dekurajuar

Mundësi zgjedhjeje?



Një ndër klisjetë e të menduarit është se e ardhmja i përket brezave të rinj dhe ata do të ndryshojnë gjërat për mirë. Por sa të interesuar dhe të fuqizuar ndihen ata përballë institucioneve shqiptare? Cilat janë qëndrimet e tyre në lidhje me demokracinë dhe zgjedhjet? Hulumtimet e kohëve të fundit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri

dhe Fondacionit Friedrich Ebert në Tiranë pasqyrojnë një peizazh të zymtë në këtë drejtim.

Shqipëria ka një moshë mesatare të popullsisë së re me rreth 31 vjeç, ku në rreth 2.8 milionë banorë, pothuajse 420 mijë janë të moshës 18-24 vjeç. Në këtë mënyrë të rinjtë përbëjnë një forcë madhore në zhvillimet politike dhe

...vijon në faqen 2 >>

Romano Prodi: Zëri i Komisionit European është zbehur



Në afatin 5 vjeçar si President i Komisionit European, Romano Prodi mbikqyri futjen e Euros, zgjerimin e Bashkimit European me tetë shtetet e ish- Bllokut Sovjetik dhe nënshkrimin e një kushtetute të BE-së.

“Motori european në kohën time ishte Komisioni. Orientimi ishte drejt një lloj Europe pothuaj federale. Në vitet e ardhshme, Europa do të ketë përparim, por nuk do të jetë e udhëhequr nga Komisioni, por nga Këshilli. Ky nuk është një ndryshim i plotë i fokusit në Europën e re” – vuri në dukje Prodi.

Ai shtoi: “Zëri i komisionit është shumë, shumë i butë. Ka interes vetëm kur zonja Merkel dhe zoti Holande takohen së bashku. Van Rompuy, i cili ishte me të vërtetë i panjohur, po bëhet hap pas hapi qendra e Europës”.

...vijon në faqen 6 >>

Gazetaria duhet të thyejë tabutë Intervistë me Besa Lucin - Kosova 2.0



Besa Luci, Kryeredaktore e Kosova 2.0

EuroSpeak: Znjsh. Luci, në punën tuaj keni prekur çështje që gazetarë të tjerë nuk do të zgjidhnin t'i mbulonin. A mund të thuhet se në sferën publike ende ekzistojnë tema tabu? Nëse po, cilat janë disa prej tyre dhe për shkak të kujt mbeten të tilla: censurës së politikës, vetë shoqërisë?

Besa Luci: Definitivisht po. Tek Kosova 2.0 publikojmë dy herë në vit një revistë në të cilën çdo herë thellohemi tek një çështje e veçantë. Deri më tani kemi folur për imazhin, korrupsionin, religjionin dhe seksin.

...vijon në faqen 4 >>

Rinia Shqiptare përballë institucioneve dhe zgjedhjeve: Konfuze dhe e dekurajuar

...vijon nga faqja 1 >>

proceset elektorale. Në zgjedhjet elektorale të vitit 2011, ishin 180 mijë të rinj shqiptarë të lindur pas rënies së regjimit komunist të cilët votuan për herë të parë, duke përbërë më shumë se 12% të votuesve.

Por, sipas një hulumtimi të Fondacionit Friedrich Ebert në Shqipëri, duket se të rinjtë në Shqipëri nuk janë shumë të interesuar mbi zhvillimet politike në vend. Vetëm një grup i vogël i tyre shprehet se është shumë i interesuar, por përqind-ja e tyre është më e ulët edhe se kategoria e të rinjve që janë krejtësisht të painedesuar. Konkretisht, vetëm 11% e të rinjve shprehen se janë shumë të interesuar, 30% e tyre të interesuar, ndërsa 33.4% janë pak të interesuar. Nga ana tjetër, 10.2% e të rinjve janë përgjigjur se janë të painedesuar dhe 14.8% janë krejtësisht të painedesuar për sa i përket zhvillimeve politike në vend.

Në raport me dallimet gjinore vërehet se **meshkujt janë më të interesuar për politikën se sa femrat**, ku 43.2% e meshkujve thonë se janë të interesuar mbi zhvillimet politike në vend përkundrejt vetëm 38.5% të femrave.

Megjithëse të rinjtë tregojnë se janë në përgjithësi të painedesuar për zhvillimet politike në vend, ata që shprehin interes për të duket se janë të shtyrë më shumë nga ideja për ta parë politikën si burim fitimi. **Të krijohet përshtypja se mes të rinjve që duan të angazhohen në politikë po hedh rrënjë ideja për të kundruar politikën si një mjet përftimesh e jo si një element për të ndrequr mangësitë e për t'i shërbyer publikut.** Kur bëhet fjalë për zhvillimet politike që ndodhin jashtë Shqipërisë të rinjtë shqiptarë janë shumë të pa interesuar.

Këto të dhëna janë një linjë me një tjetër hulumtim, të kryer nga organizata National Democratic Institute, i cili është zhvilluar gjatë vitit 2012 me fokus grupe nga rrethe të ndryshme të vendit. Pavarësisht gjinisë, vendbanimit dhe statusit social, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit bien dakord se gratë janë të papërfaqësuar në politikën shqiptare dhe shprehin dëshirën për të parë më shumë

femra në politikë. Në këtë aspekt, pjesëmarrësit theksojnë nivelin e lartë të pabarazisë gjinore në shoqëri, pikëpamjet përgjithësisht konservatore të publikut, natyrën agresive të skenës politike shqiptare dhe dominimin mashkullor në kryesimin e partive si pengesa themelore për përfshirjen e gjinisë femërore në politikë.

Shumë pjesëmarrës i perceptojnë përfitimet nga angazhimi i grave në politikë si një zgjerim të rolit të tyre tradicional të nënës dhe kujdestares. Për shumicën e pjesëmarrësve aseti më i madh i grave në politikë është tendenca e tyre për tu fokusuar në çështje sociale. Shpesh pjesëmarrësit paralelizojnë përgjegjësitë që gratë mbajnë jashtë ambientit politik me potencialin e madh që ato kanë si aktorë politik. Përgjithësisht, për pjesëmarrësit, gratë politike janë më pak të prirura ndaj korrupsionit, më pak egocentrike si edhe më shumë punëtore dhe empatike. Ata gjithashtu shfaqin besimin se nëse gratë do të ishin më të përfaqësuar, diskutimi politik do të ishte më konstruktiv dhe etik.

Të pyetura në lidhje me një përfshirje të tyre të mundshme në politikë, shumica e grave pjesëmarrëse u shfaqën hezituese. Mungesa e interesit për përfshirje politike justifikohet me argumentin se skena politike aktuale është tejet agresive dhe jo etike për to.

Shumica e të rinjve nuk besojnë se vota e tyre ka ndonjë ndikim të madh

Të dhënat e FES tregojnë se të rinjtë shqiptarë janë shumë aktivë në procesin zgjedhor. Nga të rinjtë e intervistuar të grup-moshës 19-27 vjeç, 41.5% pohuan se kanë votuar në çdo proces zgjedhor, 17.8% kanë votuar pothuajse në gjitha zgjedhjet, 32% kanë votuar në pak prej tyre dhe vetëm 8,3% u përgjigjen se nuk kanë votuar asnjëherë. Njëkohësisht, të dhënat e anketimit tregojnë se **shumica e të rinjve nuk besojnë se vota e tyre ka ndonjë ndikim të madh në mënyrën se si drejtohen institucionet.** Vetëm 10.7% besojnë se vota e tyre ndikon në shkallë të gjerë në mënyrën se si janë drejtuar institucionet dhe rreth 29.8% besojnë se vota e tyre ndikon deri diku. Një numër i madh i të rinjve, afro 25.5% besojnë se vota e tyre është shumë pak e rëndësishme dhe 29% e

konsiderojnë atë aspak të rëndësishme.

Megjithëse niveli i perceptuar i ndikimit të votës në qeverinë lokale është më i lartë se në atë qendrore, sërish vetëm 17.8% e të rinjve mendojnë se vota e tyre ka rëndësi në shkallë të gjerë. Pjesa tjetër e të rinjve ndahet mes atyre që pohojnë në masën 33% se vota ka rëndësi deri diku, 21.3% mendojnë se ajo ka shumë pak rëndësi dhe 22.8% që nuk ka rëndësi fare.

Sa i takon **perceptimeve mbi pushtetin lokal** në veçanti, interesante duken gjetjet e një anketimi të Lëvizjes Europiane në Shqipëri me 70 të rinj nga qyteti i Vlorës, Elbasanit dhe Shkodrës. Të pyetur se sa të informuar janë të rinjtë mbi rolin dhe funksionet e pushtetit vendor, zbulohet se vetëm 2% e të intervistuarve janë shumë të informuar, 16% e tyre të mirë informuar dhe pjesa që është deri diku e informuar përben edhe përqindjen më të lartë rreth 57%.

Në fakt ajo që bën përshtypje është niveli prej 25% e të rinjve që janë pothuajse të pa informuar, një përqindje mesatarisht e lartë nëse do ti referohemi faktit që tre qytetet në fjalë janë qytetet universitare. Kur studentët pyeten konkretisht mbi kompetencat e pushtetit vendor, del në pah se është një përqindje relativisht e lartë përkatësisht rreth 47.14% dhe 40.95% e të intervistuarve që kanë informacion të gabuar mbi to. Përkatësisht nga të gjithë të intervistuarit rreth 53% e tyre janë në dijeni që mbledhjet janë të hapura për publikun, përqindje kjo deri diku e përafërt me nivelin e pjesës tjetër (47%) të cilët nuk e kanë këtë informacion. Kur të rinjtë pyetën se sa të përfshirë e ndjejnë veten në vendim-marrjen lokale bie në sy fakti që ka një shumicë të konsiderueshme rreth 64.76% e të cilëve e konsiderojnë vetën pothuajse plotësisht të përfshiruar.

Të papërfaqësuar nga bashkëmoshatarët e tyre në politikë

Sipas FES, të dhënat tregojnë se vetëm një grup shumë i vogël i të rinjve, prej 3.8%, ndihen shumë të përfaqësuar nga politikanët e rinj ndërsa 27.2 % e tyre ndihen disi të përfaqësuar. Pjesa më e madhe e të rinjve, 33 %, ndjehen pak të përfaqësuar, kurse 30.8 % aspak të përfaqësuar nga bashkëmoshatarët e tyre politikanë.

Nivele shumë të ulëta besimi në institucione



Të rinjtë, të painteresuar se çfarë ndodh me të mirat publike

Të rinjtë shqiptarë kanë nivele shumë të ulëta besimi në institucionet e vendit. Në shkallën nga 0-10, ku 0 – tregon se të rinjtë ‘nuk kanë aspak besim’ në institucionet e vendit dhe 10 tregon se kanë besim të plotë, pjesa më e madhe e institucioneve renditen në nivelin 3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve renditet si institucioni më pak i besueshëm, në një nivel prej vetëm (2,4) i ndjekur nga partitë politike (2.6), Kuvendi (2.8) dhe Qeveria Qendrore (2.9). Institucioni më i besuar nga të rinjtë është Media e cila vlerësohet me nivelin 5.0 dhe që pasohet nga Policia e Shtetit (4.3).

Konfuzë mbi gjendjen e demokracisë në vend

Të rinjtë shqiptarë janë të ndarë në lidhje me vlerësimin për gjendjen e përgjithshme të demokracisë në vend. Nga të dhënat e anketimit rezultojnë se vetëm 2.8% e tyre janë shumë të kënaqur me nivelin e demokracisë në vend, përkundrazi 21.3% që shprehen se janë thjesht të kënaqur. Nga ana tjetër, 21.5% janë të pakënaqur me gjendjen dhe funksionimin e saj në Shqipëri, ndërsa 6.3% janë shumë të pakënaqur. Në tërësi vërejmë se pjesa më e madhe e të rinjve, afro 48.2%, paraqet një vlerësim mesatar për të duke shprehur në këtë mënyrë një kënaqësi të përmbajtur për gjendjen e demokracisë.

Stafi i EuroSpeak, mars 2013

Gazetaria duhet të thyejë tabutë Intervistë me Besa Lucin - Kosova 2.0

...vijon nga faqja 1 >>



Foto: Jetmir Idrizi

Ne tentojmë të sjellim një këndvështrim tjetër, duke u fokusuar tek përvojat e përditshme. Kemi parë që disa tema ende mbeten tabu, së paku në rastin e lançimit të numrit mbi seksin, i cili përfshinte edhe përvoja dhe pikëpamje të komunitetit LGBT në rajon. Ishin të shumta arsyet që na nxitën të trajtojmë këtë temë. Në veçanti, kemi pasur parasysh faktin se mungon debati mbi seksualitetin, si për shembull kur bëhet fjalë për edukatën seksuale në shkolla, e sidomos për çështjet e komunitetit LGBT. Vërehet që në rajon ka pasur disa hapa përpara të shoqërisë civile dhe medias për ta hapur si temë, ndërkohë që në Kosovë ende ngelej tabu. Duke pyetur veten se çfarë mund të bëjmë ne si media, kuptuam që së paku mund të fillojmë debatin edhe në Kosovë, duke e përfshirë homoseksualitetin në numrin e fundit të revistës. Kjo shkaktoi disa reagime negative tek grupe të ndryshme.

Në të vërtetë, prisnim shumë debate me lançimin e numrit mbi korrupsionin dhe religjionin, por nuk pati ngjarje të ngjashme me atë të lançimit të numrit mbi seksin, ku një grup protestoi kundër këtij eventit dhe shkatërroi skenën ku do të mbahej ai. Kjo pasi tashmë, pas kaq shumë ekspozimi ndaj

korrupsionit, vetë fjala e ka humbur peshën dhe kuptimin e saj për njerëzit dhe ata nuk ndihen të provokuar. Mendoj se prezantimi i numrit të revistës dedikuar seksit tregoi se ka ende tema tabu dhe ato mbeten të tilla prej vetë strukturës patriarkale të shoqërisë dhe politikës. Një strukturë që imponon nëse duhet dhe mënyrën se si duhet të diskutohet për tema të caktuara.

EuroSpeak: Suksesi në punën tuaj i detyrohet në masë të gjerë donatorëve dhe partnerëve të huaj që mbështesin gazetarinë e pavarur dhe investigative në Kosovë. Nëse në të ardhmen ata tërhiqen nga kjo zonë e Europës, a mendoni se në shoqërinë kosovare do të ketë kërkesë të mjaftueshme për ta mbajtur gjallë gazetarinë e pavarur?

Besa Luci: Donatorët në Kosovë po punojnë për të përkrahur mediat dhe për t'i bërë ato të qëndrueshme. Edhe ne të Kosova 2.0 kemi gjetur mbështetje tek ata. Si fillim kemi investuar vetë për sitin e internetit dhe pasi kemi arritur të tregojmë se ka interes nga publiku, kemi tërhequr dhe mbështetjen e donatorëve. Por jemi të vetëdijshëm që duhet të vijë momenti të bëhemi të qëndrueshëm financiarisht, pavarësisht nga mbështetja e tyre.

Personalisht, jam e kënaqur me arritjet deri tani dhe mendoj se ka interes për gazetarinë investigative dhe të pavarur në Kosovë. Ne jemi një medium i pavarur që targeton të rinjtë, sepse gjykojmë se ata janë shumë të injoruar. Kur e nisëm e dinim që kishte të rinj aktivë që shpreheshin mbi çështje të ndryshme në mediat sociale, por nuk kishin një hapërisë të tyre. Duke pasur parasysh ecurinë deri tani, mendoj se e ardhmja do të jetë pozitive. Siti jonë ka lindur dhe vazhdon me kontribute të të rinjve. Dhe përderisa ata kanë ende interes të publikohen, mendoj se dhe në të ardhmen siti do të vazhdojë. Ndërkohë, për të rritur qëndrueshmërinë financiare, në eventet dhe festat e ndryshme që organizojmë kërkojmë një kontribut modest për pjesëmarrje. Por në të ardhmen mund të pranojmë dhe publicitet si formë financimi. Ndërkohë, ndihem krenare që një projekt i tillë ekziston në Kosovë.



EuroSpeak: Tematikat që ju keni trajtuar herë pas here kanë shkaktuar pakënaqësi tek shumë palë, duke ju bërë ju edhe objekt kërcënimesh. Cili ka qenë reagimi i kolegëve, të cilët mund të ndodhen në rrethana të ndryshme për shkak të vetë karakteristikave të gazetarisë në Kosovë? A keni gjetur solidaritet tek ata?

Besa Luci: Në përgjithësi kemi gjetur përkrahje nga shumë kolegë. Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës dhe Këshilli i Mediave të Shkruara, si dhe gazetarë individualisht kanë reaguar kundër sulmit ndaj revistës mbi Seksin me kumntesa, shkrime dhe opinione në rrjete sociale. Por njëkohësisht ka pasur dhe disa media që kanë nxitur keqinformimin, duke krijuar lajme sensacionale, pa informuar dhe komunikuar me. Nuk mendoj se kjo ka qenë diçka domosdoshmërisht me qëllim negativ, por gjithsesi na kujton dhe një herë sesa shumë punë mbetet për tu bërë që gazetaria në Kosovë të përmirësohet profesionalisht. Na kujton se sa punë ende duhet të bëjnë gazetarët për të kryer rolin e tyre të informimit e edukimit në mënyrë sa më korrekte e afër së vërtetës.

Ndërkohë zbulohen të dhëna shqetësuese mbi homofobinë në Kosovë...

Në një hulumtim të kohëve të fundit mbi qëndrimet e shoqërisë kosovare ndaj homoseksualitetit, kryer nga qendra "Gani Bobi", pyetjes "si do të ndjeheshit nëse do ta kuptonit që një koleg i punës është homoseksual?", 74% e të anketuarve i janë përgjigjur si tejet homofob, ose homofob. Vetëm 13.3% janë shprehur si johomofob, ose tejet johomofob. Por, pas incidenteve që pasuan lançimin e revistës "Kosovo 2.0", A. M. nga shoqata për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT "Libertas" tha se vetëm sa është shtuar numri i anëtarëve vullnetarë të kësaj shoqate. Mes tjerash, hulumtimi konkludon se shkalla e homofobisë bëhet më e lartë sa më shumë që i afrohet rrethit shoqëror dhe familjes. Praktakisht, çdo i 20-i i anketuar është johomofob, kurse 19 të tjerë shfaqin simptoma të homofobisë së shkallëve të ndryshme, shumica të homofobisë ekstreme.

Në seksionin e homofobisë dhe partive politike në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës ka përqindjen më të lartë - 64% të përgjigjeve pozitive në pyetjen nëse homoseksualët duhet të gëzojnë të drejta të barabarta me të tjerët. Ndërsa të anketuarit nga Lidhja Demokratike e Kosovës në përgjithësi mbajnë qëndrim 50/50, njëherit më i ulëti krahasuar me katër partitë kryesore në vend. - *Gazeta Jeta në Kosovë, shkurt 2013*

Stafi i EuroSpeak, mars 2013

Romano Prodi: Zëri i Komisionit European është zbehur

...vijon nga faqja 1 >>

Dhe ndërsa Komisioni është duke u bërë më pak politik, politikanët kombëtarë po bëhen më egoistë - paralajmëroi ai. Përmend rastin e Gjermanisë, ku nuk ka më të njëjtin pasion për Europën.

Pakti "budalla" i Stabilitetit



Koha e Prodit në udhëheqjen e BE-së ka pasur momentet e saj të vështira. Një nga episodet që mbahen mend mirë ishte kur ai e quajti paktin e stabilitetit të BE - së "një budallallëk".

Pakti është krijuar në vitin 1997 për të harmonizuar politikat ekonomike në prag të futjes së euros, duke kërkuar nga shtetet anëtare që të drejtojnë financat publike "afër bilancit ose në suficit", me deficite buxhetore nën 3% dhe borxh nën 60% të PBB-së.

Prodi shprehet: "Unë kam pasur të drejtë. Pakti i Stabilitetit është një rregull aritmetike, por politika nuk është e tillë. Nevojitet një trup politik, jo një udhëzues shkolle filllore që kontrollon punët".

Ai argumenton që kur Gjermania dhe Franca nuk mund të përmbushnin kriteret e stabilitetit, ata ndryshuar paktin. Ata që kishin nxitur për Paktin e Stabilitetit, ishin të parët që e kundërshtuan dhe e hodhën në koshin e plehrave. Prodi nuk e harron momentin kur është shprehur "Shikoni, por ju nuk mund të shkoni përtej 3%" dhe përgjigja e marrë: "Mbylle, ne jemi zotët e kësaj ideje."

Nxitja kineze për Euron

Euro u prezantua në vitin 2000 në një lëvizje të cilën Prodi e përshkroi si "një ndryshim në konceptin e shtetit." Duke iu referuar Paqes së Vestfalisë të shek të 17të, një traktat i cili përcaktoi konceptin

modern të kombësisë europiane, Prodi tha: "Shteti Vestfalian është i varur nga ushtria dhe monedha e saj. Unë personalisht kam këmbëngulur për euron, sepse ishte një hap i madh për Bashkimin European dhe i nevojshëm në kontekstin e globalizimit."

Kina ka vazhduar me investimet sepse donte një alternativë ndaj dollarit amerikan, monedha dominuese në rezervat botërore dhe sepse besonte në vazhdimësinë e euros dhe rritjen e vlerës së saj.

Kushtetuta erdhi shumë herët

Përveç futjes së euros, një hap tjetër i madh ishte Kushtetuta Europiane, e cila u nënshkrua nga liderët e BE-së në vitin 2004, dhe u refuzua nga votuesit holandezë dhe francezë në referendumet në vitin 2005. Por sipas italianit 73 vjeçar, kushtetuta ishte e parakohshme.

Ai kujton diskutimet e tij me kancelarin gjerman në pushtet në atë periudhë- Helmut Kohl. "Ishte pothuajse prekëse të dëgjoje kancelarin duke u shprehur se pozita e tij nuk ishte e popullarizuar, por ai po mendonte për të ardhmen e fëmijëve dhe nipërve tanë" tha Prodi.

Dështimi i kushtetutës theu magjinë. Europa ndryshoi dhe optimizmi kaloi në pesimizëm duke krijuar idenë e Europës në vend numëro.

Prodi ende shpreson se një ditë presidenti i Komisionit European do të zgjidhet drejtpërdrejt, një ide e përmendur shpesh nga federalistët si një mënyrë për të përfshirë më shumë qytetarët europianë.

"Nevojitet një pikë në të cilën liderët më të rëndësishëm kombëtar të thonë se është në interesin tonë të shohim një lidhshmëri të ri që forcon rolin e BE-së në botë. Domosdoshmëria e globalizimit të politikës së jashtme do të nxisë këtë. Por unë nuk po e shoh këtë të ndodhë nesër."

EUObserver, 18 shkurt 2013

Kartolina nga BE-ja



Ivan Krastev, studiues në zë i çështjeve europiane dhe të demokratizimit, analizon në revistën Project Syndicate lidhjen

mes transparencës së institucioneve dhe besimit të qytetarëve në demokracitë perëndimore. Sipas tij, një nga rrjedhojat më shqetësuese të krizës financiare është pikërisht humbja e besimit tek institucionet demokratike dhe politikanët. Në vitin 2012, sondazhet identifikonin rënien më të madhe të besimit qytetar tek qeveria të regjistruar ndonjëherë. Mirëpo, a mundet një “transparencë” më e madhe – himni i ri politik i aktivistëve të shoqërisë civile dhe një numri në rritje të qeverive demokratike – ta ndryshojë këtë prirje? Shpresa është që kombinimi i teknologjive të reja, aksesit në të dhënat publike dhe rigjallërimi i angazhimit qytetar të mund t’i ndihmojë votuesit të kontrollojnë përfaqësuesit e tyre politikë në mënyrë më efikase. Por ideja se transparenca do të rivendosë besimin e publikut tek demokracia bazohet në supozime problematike. Fundi i fshehtësisë së qeverisë nuk nënkupton lindjen e qytetarit të informuar; as më shumë kontroll nuk tregon domosdoshmërisht më shumë besim tek institucionet publike. Për ta ilustruar këtë, i referohemi rastit të SHBA – ve e shumë të tjerave që vijnë nga rajoni. Pasi votuesit amerikanë mësuan se Presidenti George W. Bush kishte çuar Shtetet e Bashkuara në luftë me Irakun pa dëshmi konkrete për ekzistencën e armëve të shkatërrimit në masë, ata e ri-zgjodhën atë. Italianët mbajtën në pushtet Berlusconi për më shumë se një dekadë, pavarësisht zbulimeve të vazhdueshme të aferave të tij. Kjo do të thotë se të bindësh qeveritë të japin informacione shpjeguese nuk nënkupton që njerëzit kanë mësuar më shumë apo kuptojnë më mirë. Përkundrazi, sa më shpejt që informacioni zyrtar projektohet për të qenë i hapur për të gjithë, vlera e tij si informacionit bie dhe vlera e tij si një instrument manipulimi rritet.

Filozofi Michel Foucault thekson se akti i të vërtetës nuk mund të reduktohet në informimin e qytetarëve mbi diçka që ata nuk e dinin më parë. Pasi e vërteta në politikë është diçka që të gjithë e dinë, por që pak kanë guxim për ta shprehur. Të jetuarit e së vërtetës nuk mund gjithashtu, të reduktohet tek të pasurit akses tek informacioni i plotë. Asnjëherë informacioni nuk vjen pa interpretim. Leximi i të dhënave të papërpunuara nuk do të ishte i njëjtë mes republikanëve dhe demokratëve në SHBA, ose laikëve dhe myslimanëve në Egjipt. Kjo pasi politikë-bërja nuk mund të divorcohet nga interesat e vendim-marrësve.

Përvoja e kohëve të fundit në Rusi dëshmon qartë për ambiguitetin e politikës së besimit. Në dhjetor 2011, zgjedhjet parlamentare shkaktuan një shpërthim qytetar ku kërkohesh votim i drejtë dhe mundësi reale zgjedhjeje gjatë garës së ardhshme presidenciale. Përshkallëzimi i krizës së legjitimitetit e detyroi qeverinë të shpikë mënyra të reja për të justifikuar pushtetin e saj duke propozuar instalimin e web kamerave në të gjitha qendrat e votimit ku çdo qytetar mund të monitoronte personalisht procesin e votimit. Më shumë se 2.5 milionë persona u regjistruan për të parë procesin on line nga të paktën 188.000 web kamera të instaluar në më shumë se 94.000 qendra votimi në territorin e Rusisë. Përmes këtij instrumenti, Putini arriti dy suksese njëkohësisht: të dukej transparent në sytë e Perëndimit dhe kërcënues për shumicën e qytetarëve të tij pasi instalimi i web kamerave ishte një akt i transparencës dhe konspiracionit njëkohësisht.

Ndaj, lëvizjet për transparencë, më shumë sesa rivendosjen e besimit tek institucionet demokratike, mund të përshpejtojnë transformimin e politikave demokratike për menaxhimin e mosbesimit. Në këtë rast, mund të imagjinohet zëvendësimi i demokracisë përfaqësuese me regjime politike që kufizojnë kontrollin qytetar tek ekzekutivi. Asnjë nga këto nuk synon të mohojë se transparenca në qeverisje është një qëllim i denjë. Por le të mos mashtrojmë veten duke menduar se arritja e saj do të rikthejë besimin e qytetarëve tek institucionet politike.

Ivan Krastev, Project Syndicate, 29 janar 2012

SHBA dhe BE drejt marrëveshjes së tregtisë së lirë



SHBA dhe BE njoftojnë se do të fillojnë bisedimet mbi një marrëveshje të tregtisë së lirë, të cilat priten të nisin gjatë verës 2013.

Analistët janë të intriguar nga perspektiva e krijimit të një kundërpeshë ndaj ndikimit të fortë të Kinës, por i druhen harmonizimit të ligjeve në këto dy zona ekonomike. Konkretizimi i kësaj iniciative do të krijojë zonën më të gjerë të tregtisë së lirë.

Suksesi i kësaj marrëveshjeje varet nga vullneti i secilës palë për të bërë kompromise. E përditshmja gjermane *Süddeutsche Zeitung* shkruan se problemi nuk qëndron tek doganat, por tek barrierat që ekzistojnë përtej tyre, si për shembull standardet industriale, siguria dhe rregulloret shëndetësore, normat mjedisore dhe marrëdhëniet midis shtetit dhe biznesit. Përveç barrierave tregtare, kjo marrëveshje duhet të zgjidhë edhe pakënaqësitë e kultivuara në vite. Njëra palë kritikon Europën "socialiste", ndërsa pala tjetër denoncon "kapitalizmin çnjerëzor" të SHBA-së. E përditshmja portugeze *Público* shkruan se nëse Washingtoni dhe Brukseli do mund të tejkalojnë forcat proteksioniste në kampet e tyre, atëherë ky pakt mund të jetë model për çdo zonë tjetër ekonomike dhe mbi të gjitha do të tregojë që të dyja palët janë të afta të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për t'i dhënë fund krizave aktuale ekonomike.

Sidoqoftë, në prag të këtyre negociatave, analistët europianë bëjnë thirrje për mos-neglizhimin e problemeve aktuale që karakterizojnë BE-në. Polonia, Rumania dhe Sllovenia kanë mjaft probleme politike, ku qeveritë janë drejt rënies ose në pamundësi për të ndërmarrë reforma. Disa politikanë europianë i frikësohen valës së emigracionit nga Bullgaria dhe Rumania, kur qytetarët e këtyre vendeve të kenë akses të plotë në tregun e punës së BE-së në vitin 2014. Megjithatë Pakti i Stabilitetit duket se po përfshin interesat e gjithë shteteve, ai vazhdon të shihet si mjaft i brishtë dhe subjekt i reagimit të ekonomive problematike.

EuroTopics, shkurt 2013

A ka nevojë BE-ja për Britaninë?

Diskutimi nëse Britania duhet të jetë pjesë ose jo e BE – së do përcaktohet gjatë një referendumi i cili do të mbahet në vitin 2017, ndonëse deri atëherë gjërat mund të ndryshojnë. Nëse eurozona mbijeton, vendet jashtë saj nuk do të kenë më shumë rëndësi.



Por a dëshirojnë europianët që Britania të jetë pjesë e BE – së? Shtetet më të vogla veriore, si Holanda, tradicionalisht kanë kërkuar që Britania të jetë në BE. Pasi pa Britaninë, ata do të dominoheshin nga Franca dhe akoma më shumë nga Gjermania. Por vetë Gjermania do të preferojë të mbajë partnerin e saj britanik, në vend që të përballet e vetme me vendet mesdhetare. Gjithashtu, nga pikëpamja kulturore gjermanët kanë shumë më tepër të përbashkëta me britanikët, sesa me grekët apo italianët. Ndërkohë, sipas një sondazhi të kohëve të fundit, 54% e francezëve do të preferonin që Britania ta linte BE – në. Rikujtojmë se presidenti de Gaulle ka bllokuar dy herë hyrjen e Britanisë në Komunitetin Ekonomik Europian, duke qenë dyshues ndaj potencialit anglo-sakson. Krahas kulturës dhe kombësisë, ekziston edhe një dimension politik për ndjenjat pro apo kundër Britanisë në BE. Francezët që dëshirojnë largimin e Britanisë nga BE – ja janë të majtë, ndërsa shumica që ka pikëpamjen e kundërt janë të djathtë. Gjithsesi, rezistenca britanike ndaj planeve të mëdha europiane është një kurajë demokratike dhe duhet të shërbejë si një korigjuese për utopizmin teknokrat. Ata që favorizojnë BE - në duhet t'i marrin kritikën ndaj saj seriozisht, pasi kështu mund të sigurohet një Europë e bashkuar, demokratike dhe ekonomikisht e dobishme. Kjo është arsyeja pse Europa ka nevojë për Britaninë: jo si një qendër bankare dhe tregtare, por si një partner demokratik.

Project Syndicate, 3 shkurt 2013

Vendet nordike, modeli i ardhshëm



Kur është fjala për reformimin e qeverisë, vendet e vogla shpesh janë në pararojë. Mesa duket vendet nordike janë të favorizuara për të marrë një rol të ngjashëm për dy arsye kryesore: a) kanë arritur të menaxhojnë vetë krizën e borxhit në vitin 1990, b) ofrojnë një plan për politikanët e majtë dhe të djathtë sesi duhet reformuar sektori publik duke e bërë shtetin shumë më efikas dhe të përgjegjshëm.

Pjesa e shpenzimeve të qeverisë suedeze në PBB, e cila ka rënë me rreth 18%, është më e ulët se ajo e Francës dhe së shpejti mund të jetë më e ulët se ajo e Britanisë. Norma e korporatave është 22%, shumë më e ulët se ajo e Amerikës. Deficiti i saj buxhetor është 0.3% e PBB, ndërsa në Amerikë kjo shifër është 7%. Lidhur me shërbimet publike, për aq kohë sa ato funksionojnë, për ta nuk ka rëndësi nëse është shteti apo agjencitë private që i ofrojnë. Suedia ka një sistem universal të sistemit arsimor, ku shkollat private fitimprurëse konkurrojnë me ato publike. Ajo i jep qytetarëve të saj akses në të gjithë të dhënat zyrtare dhe 30% e fuqisë së saj punëtore është e punësuar në sektorin publik, në krahasim me 15% e mesatares së OBEZH.

Gjithsesi, modeli nordik nuk është i përsosur pasi: shpenzimet publike si përqindje e PBB janë ende të larta; niveli i lartë i tatimeve inkurajon sipërmarrësit të lëvizin jashtë shtetit; shumë emigrantë jetojnë jashtë-përfitimeve, etj. Ajo që mund të përfitohet nga modeli nordik është mjaft praktike. Shteti nuk është popullor, sepse ai është i madh, por sepse ai punon. Një vend mund të injektojë mekanizmat e tregut në shtetin e mirëqenies sociale për të përmirësuar punën e tij. Por paralelisht duhet të jetë i gatshëm të çrrënjosë korrupsionin dhe të mirëpresë ide të mira të gjithë spektrit politik.

Economist, 2 shkurt 2012

Rrjetet e trafikimit të drogës online dhe rreziku për BE-në

Komisionerja për Punët e Brendshme në BE, Cecilia Malmstrom, gjatë një pronocimi për mediat vuri në dukje rritjen gjithnjë e më shumë të rolit të tregjeve online në BE.

“Interneti garanton një mënyrë të shpejtë dhe të sigurtë komunikimi për konsumatorët dhe kriminelët. Si pasojë është duke u kthyer në një treg virtual. Këto prirje të reja janë globale dhe po përhapen më shpejt se më parë.”

Ajo shtoi se përpjekjet e BE-së për të luftuar trafikun e drogës vështirësohen së tepërmi për shkak të kompleksitetit dhe inovacioneve nga ana e trafikantëve si dhe të diversitetit të substancave të paligjshme që qarkullojnë në BE.

Komisioni u bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të ndalojnë përdorimin e drogës së re sintetike 4 – metilafentamine (4 MA).

Droga në fjalë është e paligjshme në 10 shtete të BE-së dhe dyshohet se ka shkaktuar vdekjen e 21 personave në dy vitet e fundit.

EuroNews, 1 shkurt 2013

Sektori teknologjik i Europës duket se do të sfidojë Hollywood-in



Harri Koponen, zyrtari më i lartë operativ i Rovio, firma finlandeze e cila krijoi lojën e famshme Angry Birds, tha se kompania ka ndërtuar “një nga studiot më të mëdha të animacionit në Europë” e cila do të nisë punën këtë pranverë. Firma ka punësuar producentin e famshëm të Hollywoodit, John Cohen dhe pret të publikojë filmin e saj të parë të animuar me metrazh të gjatë, Angry Birds, në vitin 2016. Kalimi nga sukcesi në krijimin e aplikacioneve në sfidimin e animatorëve tradicionalë tregon se si përdorimi i smartphone-ve dhe tabletave ka thyer barrierat ndërmjet

sektorëve tradicionalisht të ndryshëm, të tillë si argëtimi, arsimit dhe komunikimi.

Sipas Observatorit Audiovizual European, ka më shumë se 700 shërbime audiovizuale sipas kërkesës në Europë, dhe numri vazhdon të rritet. Risi të tjera europiane, të cilat janë duke u bërë histori suksesi po shfrytëzojnë modele të vjetra biznesi. Kompania italiane *Paperlit* i jep mundësinë medias tradicionale dhe botuesve të vënë përmbajtjen e tyre në dispozicion të përdoruesve të smartphone dhe tabletave. Ndër klientët e Paperlit mund të përmenden Bloomberg BusinessWeek, BBC dhe Wired. Kompania franceze Captain Dash ka krijuar një aplikacion i cili i jep mundësinë kompanive të mbledhin të dhënat e tyre në kohë reale.

Përveç promovimit të tyre në tregjet vendase, duke pasur aplikacionet si "pasaportë" dhe duke marrë parasysh përdorimin global të smartphone, këto kompani po synojnë tregun ndërkombëtar. Europa përfaqëson 2/3 e operatorëve botërorë të telefonisë virtuale, me 5 nga 10 tregjet më të mira botërore për sa i përket telefonisë celulare: Zvicër, Holandë, Norvegji, Francë dhe Irlandë. Ky fakt po ndikon në tërheqjen e kompanive të huaja për të themeluar qendrat e tyre të inovacionit në Europë.

EurActiv, Shkurt 2013

Në pritje të aderimit

Maqedoni – Bullgari, përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet



Në një përpjekje për të ndrequr bllokimin që Bullgaria i bëri Maqedonisë në rrugën e saj drejt BE-së, Kryeministri bullgar Boyko Borisov ftoi homologun e tij maqedonas Nikola Gruevski në Sofje. Borisov deklaroi se Shkupi mund të

mbështetet në përkrahjen e Sofjes në rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe Nato. Ai gjithashtu shprehu interesin e tij mbi diskutimin e çështjeve ekonomike, si ndërtimi i autostradës Sofje-Shkup-Tiranë.

Megjithatë, deri tani, nuk ka pasur asnjë përgjigje nga Shkupi për ftesën e Borisov. Presidenti bullgar, Rosen Plevneliev, gjithashtu ka deklaruar se një nga prioritetet kryesore të këtij viti do të jetë ngritja e marrëdhënieve të mira fqinjësore me Maqedoninë. Grupet e punës së ministrive të jashtme maqedonase dhe bullgare, vazhdojnë të punojnë mbi draftin e traktatit të miqësisë së re, marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit mes dy vendeve, të hartuara nga Bullgaria.

Sidoqoftë, sipas analistëve maqedonas, këto përpjekje të bëra nga qeveria bullgare nuk kanë qëllime të sinqerta për të rregulluar marrëdhëniet. Ish ambasadori i Maqedonisë, Risto Nikovski, tha se Bullgaria vazhdon të njëjtën politikë mohimi drejt Maqedonisë. Mjaft deklarata rreth marrëdhënieve midis dy shteteve po bëhen si pjesë e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare në Bullgari

SETimes, shkurt 2013

Kroacia drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjes me Slloveninë para hyrjes në BE

Kroacia dhe Sllovenia ndërmorën një hap përpara drejt zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje prej 270 milionë eurosh, e cila daton në ndarjen e aseteve të bankës jugosllave, duke minimizuar kështu rrezikun e bllokimit të anëtarësimit të Kroacisë në BE nga Sllovenia. Ministrat e jashtëm të secilit vend deklaruan se janë kaluar gjithë barrierat teknike. Çka mbetet është një zgjidhje politike nga dy qeveritë.

Sllovenia dhe Kroacia po diskutojnë prej vitesh mbi pretendimet e Kroacisë për borxhin që Nova Ljubljanska Banka d.d. i ka kursimtarëve kroatë. Sllovenia, anëtare e BE - së që kontrollon NLB, ka kërcënuar të vërë veton ndaj pranimit të Kroacisë në qoftë se këto akuza nuk tërhiqen, në një kohë kur dalja e Kroacisë nga kriza ekonomike varet nga 10 miliard euro grante të BE-së. Në këtë fazë,

Ministrja e Jashtme e Kroacisë, Vesna Pusic, ka deklaruar se Kroacia nuk do t'i tërheqë paditë nga gjykatat e saj, por po punohet për një zgjidhje të pranueshme ku të mos dëmtohet asnjë palë.

Në kuadër të anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE, e vetmja mosmarrëveshje e cila mbetet e pazgjidhur është ajo midis Kosovës dhe Serbisë. Edhe kjo mosmarrëveshje ka pasur zhvillime relativisht pozitive, pasi për herë të parë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në 2008, krerët e dy shteteve u takuan në Bruksel, ku folën për normalizim të marrëdhënieve.

Stafi i EuroSpeak, shkurt 2013

Perspektivat integruese Europiane të Turqisë dhe joshja e lindjes

“Nuk është fundi i botës nëse BE – ja nuk na pranon në gjirin e saj.” Kështu u shpreh Kryeministri i Turqisë Rexhep Taip Erdogan gjatë një vizite zyrtare në Budapest me 6 shkurt 2013.

Sipas tij, fakti që Turqia është një shtet islamik, kushtëzon vonesat në procesin e anëtarësimit të vendit të tij në BE. Ai shton se këto vonesa janë të pafalshme dhe ka kërcënuar disa herë me anëtarësimin e Turqisë në Organizatën e Bashkëpunimit të Shangait, në të cilën bëjnë pjesë Rusia, Kina dhe shtetet e Azisë Qendrore.

Qëndrime të tilla frustuese vijnë në një kohë kur Turqia po i afrohet 50 vjetorit të marrëveshjes me Komunitetin Ekonomik Europian, që do ta çonte vendin e Bosforit drejt një anëtarësimi në bllokun Europian. Por sot duket sikur politika integruese në BE nuk bën më pjese në axhendën e qeverisë turke.

Turqisë ende i duhet të kryerjë një sërë reformash në politikën e saj të brendshme dhe të njohjë Qipron, një shtet anëtar i BE-së, si shtet Sovran. Por tashmë është përforcuar bindja se edhe nëse ajo ecën përpara me këto reforma, nuk do të mjaftojë që të bindë vendet bllokuese, si për shembull Franca, por edhe të tjerë, që të pranojnë anëtarësimin.

Pavarësisht nga ato që u thanë më sipër, as Turqia dhe as BE – ja nuk kanë interes të ndër marrin një

hap strategjikisht të gabuar. Për sa i përket çështjes së anëtarësimit në Organizatën e Bashkëpunimit të Shangait, si një alternativë ndaj BE – së, kjo përbën një problem më vete duke qenë se Turqia është një shtet anëtar i NATO – s. Aq më tepër që kjo do të shqetësonte shumë një ndër aleatët kryesorë të Turqisë, SHBA – të. Pra deklaratat e Erdoganit shërbejnë më tepër për të konsoliduar pozitën gjeopolitike të Turqisë si një fuqi ekonomike dhe ushtarake vazhdimisht në rritje.

International Herald Tribune, 6 shkurt 2013



- Kompanitë europiane dhe ato amerikane përbejnë 2/3 (65%) së top listës së kompanive të kërkimit dhe zhvillimit në mbarë botën. (Burimi: Transatlantic Economy 2011)
- Tregtia BE-SHBA u rrit me 636 miliardë dollarë në vitin 2011, 14% më shumë se vitin e kaluar. (Burimi: Departamenti Amerikan i Tregtisë, Administrimit Ndërkombëtare të Tregtisë)
- Ekonomia transatlantike gjeneron përafërsisht 5 trilion dollarë në total nga shitjet në vit dhe punëson deri në 15 milionë të punëtorëve në të dyja anët e Atlantikut. (Burimi: Transatlantic Economy 2011)
- Ekonomia transatlantike është tregu më i madh dhe i pasur në botë, që përbën mbi 54% të PBB të botës në aspektin e vlerës dhe 40% në aspektin e fuqisë blerëse. (Burimi: Transatlantic Economy 2011)
- SHBA dhe Europa janë burim parësor i njëritjetrit dhe destinacioni për investimet e huaja direkte (FDI), duke përbërë më shumë se 60% të aksioneve të stokut të brendshëm të investimeve të huaja direkte dhe më shumë se 75% të stokut të jashtëm të FDI në mbarë botën në vitin 2009. (Burimi: Transatlantic Economy 2011)
- Investimet amerikane në Holandë gjatë periudhës 2000- 2010 ishin nëntë herë më shumë se investimet e SHBA – ve në Kinë, gjatë të njëjtës

periudhë. Investimet amerikane në Britaninë e Madhe ishte më shumë se shtatë herë më shumë, dhe në Irlandë gati tre herë më shumë, sesa në Kinë. (Burimi: Transatlantic Economy 2011)

● Një studim i vitit 2009 ka zbuluar se duke hequr 50% të masave aktuale jo-tarifore në tregtinë bilaterale BE- SHBA, PBB e tyre mund të nxitet me më shumë se 160 miliardë euro (rreth 208 miliardë \$). (Burimi: Komisioni Europian)

● Sipas një studimi të vitit 2011, fitimet nga një marrëveshje e tregtisë së lirë mes BE dhe SHBA mund të shtohen deri me gati 120 miliardë Euro (rreth 156 miliardë \$). (Burimi: Qendra Europiane për Ekonomi Politike Ndërkombëtare)

● BE dhe SHBA së bashku kanë kontribuar me më shumë se 100 miliardë dollarë në asistencën zyrtare për zhvillim në vitin 2010. (Burimet: OBEZH, USAID, EuropeAid)

● Që nga janari i 2011, rreth 1.7 milion refugjatë nga e gjithë bota e quajnë SHBA ose një shtet anëtar të BE-së si shtëpinë e tyre. (Burimi: Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët)

● Në 2009-2010, më shumë se 188.000 studentë nga SHBA dhe BE kanë studiuar jashtë vendit të tyre në anën tjetër të Atlantikut. (Burimi: Instituti i Edukimit Ndërkombëtar)

● Më shumë se 10 milionë turistë europianë kanë udhëtuar drejt SHBA në vitin 2010. (Burimi: Departamenti Amerikan i Tregtisë dhe Administrimit Ndërkombëtar të Tregtisë)

Buxheti i Bashkimit Europian: Ku shkojnë paratë?

- 44% Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve natyrore
Politika e përbashkët agrikuturore dhe zhvillimi rural (57.3 miliardë)
- 1% Liri, siguri dhe drejtësi
Punë të brendshme (1.8 miliardë)
- 5% BE si një aktor global
Çështje të jashtme (7.1 miliardë)
- 6% Administrata (8.4 miliardë)
- 10% Konkurrenca për zhvillim dhe punësim
Kërkime dhe teknologji (12.3 miliardë)
- 33% Kohezion për zhvillim dhe punësim
Punë, lidhje territoriale dhe bashkëpunim (42.3 miliardë)
- 100% shpenzime totale (129.3 miliardë)

Portali i BE - së



Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritimit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit Europian.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org

twitter.com/EMAlbania 
facebook.com/EMinALB 

European Movement-Albania
Rr. Brigada VIII, Godina 1/3, Ap.9, Tiranë, Albania,
Nr. Tel/Fax: +355 4 2253184, www.em-al.org, info@em-al.org

